

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit P.B., nga P., për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par.1 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga i dënuari P.B., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr. 206/2015 datë 07.12.2016, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.70/2017 datë 15.09.2017, në seancën e kolegjit e mbajtur më 26 mars 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit P.B., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.206/2015 datë 07.12.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.70/2017 datë 15.09.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr. 206/2015 datë 07.12.2017, i dënuari P.B. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par.1 të KPK-së, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 19.05.2011 deri më datë 11.07.2011. Në pajtim me nenin 364 pika 1.3 të KPP-së i dënuari është liruar nga akuza për shkak të veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK-së, për shkak se

nuk është provuar se i dënuari ta ketë kryer veprën penale, si dhe për veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, është refuzuar akuza, për shkak se prokurori ka hequr dorë nga ndjekja penale për këtë vepër penale. Është obliguar i dënuari që të paguaj paushallin gjyqësor në lartësi prej 200 euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.70/2017 e datës 15.09.2017, ka refuzuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesën e mbrojtësit të dënuarit, përkitazi me veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par.1 të KPK-së, aktgjykimi në këtë pjesë është vërtetuar, kurse me rastin e ankesave sipas detyrës zyrtare është ndryshuar aktgjykimi, përkitazi me veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK-së, ashtu që është refuzuar akuza, pasi që ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari P.B., për shkak të shkeljeve të ligjit penal nga neni 385 par.1 nënpar.1.1 të KPPK, dhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPP-së nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 të KPP-së, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Prokurori i Shtetit, me parashtresën KMLP.II.nr.194/2017 e datës 13.10.2017, ka paraqitur përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë i dënuari pretendon se aktgjykimi i ankimuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse është përpiluar në kundërshtim me nenin 370 par.6 dhe 7. Aktgjykimi në arsyetim nuk i paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit. Gjithashtu gjykata nuk paraqet në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata është dashur që në mënyrë të veçantë të vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse. Po ashtu në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendohet se aktgjykimi është bazuar në prova të papranueshme- përgjimin e bisedave telefonike.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e të dënuarit janë të pabazuara, meqë aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje të ligjit penal e as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Kështu në këtë çështje penalo juridike, dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i qartë, konkret, i njëjti nuk përmban kundërthënie me vet veten e as me arsyetimin e tij, po ashtu i njëjti në përshkrimin faktik të veprës penale përmban të gjitha elementet objektive dhe subjektive të cilat përbëjnë figurën e veprës penale. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike, duke shpjeguar qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr si të provuara ose të pa provuara, duke bërë kështu vlerësimin e provave kontradiktore konform nenit 370 par.7 të KPP.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë vlerësimin e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i paraqitur lidhur me këto konkludime, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Arsyet të cilat i ka dhënë gjykata e shkallës së parë, kanë mbështetje në provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, dhe atë në deklaratat e të dëmtuarve N.M., M.Th., G.Th., T.Ç. dhe M.B., të cilët përveç që vërtetojnë faktet dhe rrethanat se kanë biseduar me të dënuarin personalisht, për mënyrën e marrjes së patentë shoferit, vërtetojnë edhe faktet dhe rrethanat për mënyrën e dhënies së parave për një gjë të tillë. Përveç nga dëshmitë e këtyre të dëmtuarve-dëshmitarëve, kjo çështje është vërtetuar edhe me provat tjera materiale - përgjimet telefonike, si në shkresat e lëndës, ku në detaje gjatë bisedave në fjalë në mes të dënuarit dhe të dëmtuarve, vërtetohen faktet dhe rrethanat se i dënuari iu ka marrë parat të dëmtuarve - shuma që janë paguar nga të dëmtuarit për pjesën teorike dhe praktike të provimit për patentë shofer, duke iu premtuar se do ti kalojë në provim për patentë shoferë. Nga bisedat telefonike vërtetohet se i dënuari ka folur disa herë me të dëmtuarit e ndryshëm dhe nga të njëjtit ka kërkuar shuma të ndryshme të parave, duke filluar nga 250-350 e ndonjë herë edhe 500 euro.

Po ashtu edhe sa i përket statusit zyrtar të dënuarit, gjykata ka dhënë arsye të mjaftueshme, duke vërtetuar se i dënuari përveç që ka qenë i punësuar në auto shkollën “ G...”, si person zyrtar -instruktor - i autorizuar për përgatitjen e kandidatëve për provim, dhe atë për pjesën praktike

dhe teorike, ka qenë i autorizuar edhe për mbajtjen e ligjëratave si ato teorike dhe praktike. Sipas dispozitës së nenit 120 par.2 të KPRK person zyrtar nënkupton:

2.1 personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ shtetëror;

2.2 personi i autorizuar në një organ shtetëror; organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik i cili sipas ligjit ose ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligj ushtron detyra të posaçme;

Nga kjo dispozitë mund të kuptohet se i dënuari ka pasur cilësinë e personit zyrtar, prandaj edhe në këtë drejtim plotësohen të gjitha elementet e veprës penale që kërkohet me dispozitat e nenit 343 par.1 të KPK-së. Po ashtu si të pabazuara janë pretendimet e të dënuarit se gjykata aktgjykimin e ka bazuar në prova të papranuara-përgjimet e telefonatave dhe se të dënuarit P.B. në asnjë fazë të procedurës nuk i është mundësuar që të ballafaqohet me këta dëshmitarë-të dëmtuar. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës pretendimi se aktgjykimi është i bazuar në prova të papranuara - në përgjimet e telefonatave nuk qëndron, ngase nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i kundërshtuar rezulton se përgjimet e telefonatave janë prova të pranueshme, janë të ligjshme dhe janë zbatuar me masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe të hetimit në pajtim me ligjin në bazë të urdhrit të lëshuar nga Gjykata P.nr.30/11 të dt. 29.03.2011 mbi përgjimin e telekomunikimeve. Nga bisedat telefonike të të dënuarit P.B., janë vërtetuar faktet dhe rrethanat se i dënuari iu ka marr para të dëmtuarve, duke iu premtuar se do ti kalojë në provimin për shofer, është vërtetuar se i njëjti ka pasur komunikime të vazhdueshme me persona të ndryshëm në mesin e tyre edhe me kandidatët V.V., nga i cili ka marr shumen prej 400 €, nga F.G. ka marr shumen prej 350 €, nga N.Sh., ka kërkuar dhe ka marr shumën prej 500 € nga A. N. lidhur me kalimin e një kandidati kërkon 650 €, nga F.N lidhur me kalimin e dy kandidatëve kërkon shumën prej 850 €. Po ashtu edhe pretendimi se të dënuarit P.B., në asnjë fazë të procedurës nuk i është dhënë mundësia që të ballafaqohet me dëshmitarët është i pabazuar, ngase të gjitha deklaratat e dëshmitarëve, në të cilat deklaratat edhe është bazuar aktgjykimi i kundërshtuar janë proceduar në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjë që vërtetohet nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor në shkresat e lëndës P.nr.206/15 datë 15.06.2016, ku të dënuarit i është dhënë mundësia e drejtpërdrejt që ti kundërshtoj deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar si dhe të paraqesë vërejtjet në dëshmitë e tyre.

Prandaj, në bazë të paraqiturave më lartë, rezulton se në veprimet inkriminuese të të dënuarit P.B., përmbushen të gjitha elementet e veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par.1 të KPK-së, për çka nuk janë të bazuara as pretendimet për shkeljen e ligjit penal.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoj se aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkeljen e ligjit penal dhe shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat në kërkesë pretendohen dhe në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË  
Pml.nr.279/2017, më 26 mars 2018

Procesmbajtës,  
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,  
Emine Mustafa